

BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

V E N D I M

Nr. 53 Datë 27/03/2020

“Për Përdorimin e Fondit të Emergjencave Civile, nga Granti & Të Ardhurat”

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, duke u mbështetur në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe ligjit nr.88/2019 datë 18.02.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020”, i miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër nr.140 datë 26.12.2019, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me vendimin , nr.16/1 prot. datë 17.01.2020, bazuar në Vendimin nr.243 datë 24.03.2020 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, kërkojmë që të përdoret fondi emergjencave civile për dhënie e pakove ushqimore në situatën e krijuar nga Coronavirus (COVID-19), për t’ju ardhur në ndihmë familjeve në nevojë nga ana e Bashkisë Dibër, në mbledhjen e datës 27/03/2020 me 18 vota pro, — kundër, — abstenim:

Vendosi:

- I. Përdorimin nga fondi emergjencave civile, nga granti dhe të ardhurat, t’u jepet ndihmë në formën e pakove ushqimore familjeve në nevojë si pasojë e situatës së krijuar nga Coronavirus (COVID-19).
- II. Pakësohet fondi emergjencave civile **1810** në vlerën 5.000.000 (pesëmilion) lekë dhe shtohet struktura **1110** llogaria **604** në vlerën 5.000.000 (pesëmilion) lekë.
- III. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Prokurimeve dhe Drejtoria Ekonomike (Sektori i Financës) pranë Bashkisë Dibër.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër.

SEKRETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

KRYETAR KËSHILLIT BASHKIAK

Inva TRUPJA

Sokol SAVA